

## Vendim nr. 14 datë 24.01.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Anëtare  
Fiona Papajorgji, Anëtare  
Ilir Toska, Anëtar

në datën 24.01.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 34 (B) 2022 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **BARDHYL IBRA**

**OBJEKTI:** **Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm të kërkesës nr. 9/2021 të regjistrit themeltar, datë 29.12.2021 pranë sekretarisë së Gjykatës së Lartë.**

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është ndjekur penalisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 246/1 i Kodit Penal të

kohës (KP). Ai i është drejtuar me kërkesa prokurorit të rrethit dhe Prokurorit të Përgjithshëm për zëvendësimin e prokurorit që ndiqte hetimin paraprak të çështjes së tij, për të cilat është njoftuar për mospranimin. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zëvendësimin e prokurorit të çështjes. Gjyqtarja M.L., me vendimin nr. 582 akti, datë 09.09.2015, ka vendosur shpalljen e moskompetencës për shqyrtimin e çështjes dhe dërgimin e akteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, si gjykatë kompetente.

2. Në datën 20.04.2017 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi kundër gjyqtarës M.L., ish-kancelarit E.A. dhe kancelarit D.Xh. të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt: *“1. Detyrimin e të paditurve për shpërblimin e dëmit pasuror në vlerën 300.000 (treqindmijë) ku përfshihen përpilimi, postimi dhe vajtje e ardhje në Gjykatën e Rrethit Tiranë, nëpër gjykime e sekretari. 2. Detyrimin e të paditurve për shpërblimin e dëmit jopasuror në vlerën prej 3.000.000 (tremilionë) lekë për shkelje të rëndë kushtetuese të bërë kundër meje, duke më shkaktuar mjaft strese, shqetësim e provokim.”*

3. Me vendimin nr. 4538, datë 22.11.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, bazuar në nenet 154/a dhe 158 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) dhe nenin 25, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, ka vendosur kthimin pa veprim të kërkesëpadisë dhe akteve shoqëruese të saj, për shkak të të metave formale, konkretisht mungesës së akteve që i duheshin bashkëlidhur kërkesëpadisë, të cilat duhet të ishin në formën e kërkuar nga ligji, si dhe mospagesës së taksës për shpenzimet gjyqësore.

4. Kërkuesi ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 4538, datë 22.11.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31146-00170-86-2018 regjistri themeltar, datë 15.01.2018.

5. Në kushtet kur ankimi i tij drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit nuk ishte shqyrtuar ende, në datën 11.12.2019 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë me objekt: *“Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjyimit brenda një afati të arsyeshëm, të parashikuar nga shkronja “a” e nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile; neni 48, pika 2, i ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” të çështjes administrative të regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31146-00170-86-2018, datë 15.01.2018 dhe detyrimin e kësaj gjykate për përshpejtimin e gjyimit të çështjes.”* (kërkesa e parë).

6. Në datën 28.03.2020 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë. Me vendimin nr. 13, datë 05.02.2021, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, duke vlerësuar se në kushtet kur Gjykata e Lartë nuk ishte shprehur ende me vendim për kërkesën për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet juridike përpara se t'i drejtohej Gjykatës.

7. Në datën 09.06.2021 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për zëvendësimin e gjyqtarëve S.S., I.P. dhe E.P. nga shqyrtimi i çështjeve civile të tij të caktuara për në datën 17.06.2021, e cila i është kthyer pa veprim me shkresën nr. 1967/1 prot., datë 11.06.2021 të kancelarit të Gjykatës së Lartë.

8. Në datën 23.06.2021 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e nenit 474 të KPC-së, të ndryshuar me nenin 20 të ligjit nr. 44/2021, datë 23.03.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, si të papajtueshëm me Kushtetutën; konstatimin e shkeljes së të drejtave kushtetuese të aksesit dhe sigurisë juridike, të parashikuara në nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës, si dhe nenet 6 e 41 të KEDNJ-së; konstatimin e pavlefshmërisë absolute të shkresës nr. 1967/1, datë 11.06.2021 të kancelarit të Gjykatës së Lartë. Me vendimin nr. 109, datë 27.09.2021, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke arsyetuar se vendimi i pranimit ose jo të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes, nuk është vendim përfundimtar për efekt të gjykimit kushtetues, pasi nuk vendos në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Si i tillë, ai nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata, pasi ajo kontrollon në shkallë të fundit kushtetutshmërinë e akteve, të cilat janë përfundimtare dhe sjellin pasoja negative për individin.

9. Në lidhje me kërkesën e parë të kërkuesit drejtuar Gjykatës së Lartë, për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, me vendimin nr. 11/17/9, datë 22.12.2021, Kolegji Administrativ ka vendosur rrëzimin e saj. Ky vendim pranohet nga kërkuesi se i është komunikuar në datën 07.02.2022 nëpërmjet shërbimit postar.

10. Më herët, në datën 29.12.2021, kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për shkak të mosshqyrtimit të

çështjes nga ajo gjykatë brenda afatit 45-ditor (*kërkesa e dytë*). Kjo kërkesë është regjistruar me nr. 9/2021 të regjistrimit themeltar.

11. Në datën 18.05.2022 kërkuesi i është drejtuar përsëri Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes administrative nr. 31146-00170-86-2018 akti, datë regjistrimi 15.01.2018 në Gjykatën Administrative të Apelit dhe çështjes nr. 11/17/9 regjistri, datë 11.12.2019 në Gjykatën e Lartë. Në lidhje me këtë kërkesë, në datën 01.07.2022 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin nr. 86, datë 13.07.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

12. Ndërkohë, për kërkesën e dytë të paraqitur nga kërkuesi në Gjykatën e Lartë, me vendimin nr. 9, datë 19.07.2022, një kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë (Kolegji Penal), bazuar në pikën 3 të nenit 399/7 të KPC-së, ka vendosur pushimin e gjykimit, me arsyetimin se kërkesa e parë është marrë në shqyrtim dhe është gjykuar në themel me vendimin e datës 22.12.2021, për rrjedhojë çështja për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë dhe përshpejtimin e procedurave ka mbetur pa objekt. Po kështu, Kolegji Penal ka vlerësuar se dispozitat e KPC-së nuk garantojnë të drejtën e palës në proces për të kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për organin që shqyrton kërkesën për shkeljen e afatit të arsyeshëm për çështjen e themelit. Kërkimi për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga Kolegji Administrativ, për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit, është i papranueshëm, pasi nuk ka lëndë dhe objekt gjykimi. Vendimi i Gjykatës së Lartë pranohet nga kërkuesi se i është komunikuar në datën 03.08.2022 nëpërmjet shërbimit postar.

13. Me kërkesën e datës 01.12.2022, kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor nga Gjykata e Lartë, si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të parashikuar nga nenet 399/6, shkronja “c” dhe 399/7, pika 2, të KPC-së, të kërkesës nr. 9/2021 të regjistrimit themeltar.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

14. *Kërkuesi* pretendon se vendimi nr. 11/17/9, datë 22.12.2021 i Gjykatës së Lartë i është komunikuar më 07.02.2022, pra jashtë afatit ligjor. Në pritje të shqyrtimit të kërkesës së

parë, ai ka paraqitur një kërkesë tjetër në Gjykatën e Lartë, atë nr. 9/2021 të regjistrit themeltar, datë 29.12.2021, shqyrtimi i së cilës është bërë tej afateve ligjore të parashikuara nga nenet 399/6 dhe 399 të KPC-së. Kërkesa e dytë është shqyrtuar në datën 19.07.2022 dhe i është komunikuar kërkuarit në datën 03.08.2022. Duke llogaritur kohëzgjatjen nga data e regjistrimit deri kur është bërë gjykimi, shqyrtimi i saj ka zgjatur 6 muaj e 22 ditë, ndërsa referuar datës së komunikimit të vendimit, ka zgjatur 7 muaj e 22 ditë, ndërkohë që afati i shqyrtimit sipas ligjit është 45 ditë. Për rrjedhojë, kërkuari ka pretenduar se është cenuar parimi i sigurisë juridike, si dhe e drejta për proces të rregullt si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm të kërkesës nr. 9/2021 të regjistrit, datë 29.12.2021 nga Gjykata e Lartë.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

16. Kolegji vëren se kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Lartë me dy kërkesa për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt, si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. Kërkesa e parë kishte të bënte me kohëzgjatjen e procesit në Gjykatën Administrative të Apelit për shqyrtimin e ankimit të tij, kurse kërkesa e dytë me kohëzgjatjen e shqyrtimit nga Gjykata e Lartë të asaj kërkesë. Kurse në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese kërkuari ka pretenduar konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt për shkak se Gjykata e Lartë, gjatë shqyrtimit të këtyre dy kërkesave, nuk ka respektuar afatin 45-ditor dhe procedurat që rregullojnë njoftimin e vendimit.

17. Në lidhje me kërkesën e parë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 11/17/9, datë 22.12.2021 ka vendosur rrëzimin e saj, duke vlerësuar se edhe pse në momentin e paraqitjes së kërkesës afati i arsyeshëm i shqyrtimit në gjykatën e apelit ishte tejkaluar, nuk konstatohej ndonjë zvarritje e qëllimshme e çështjes nga gjyqtari relator. Kërkuesi është njoftuar rregullisht për këtë vendim në datën 07.02.2022. Më pas, ai ka paraqitur ankim kushtetues individual, për të cilin, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 86, datë 13.07.2022, ka vendosur moskalimin për shqyrtim në seancë plenare, për shkak se kërkuesi nuk ka arritur të justifikojë interesin e tij për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, pra në lidhje me pretendimet e tij për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit. Sipas këtij vendimi, *“me vendimin nr. 4538, datë 22.11.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur t’i kthejë kërkuesit kërkesëpadinë me objekt shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, për shkak të mosplotësimit të kriterëve ligjore, konkretisht të të metave formale në paraqitjen e saj dhe mospagimit të taksës për shpenzimet gjyqësore (shih paragrafin 3 të vendimit). Po kështu, nga materialet e dorëzuara nga kërkuesi së bashku me ankimin kushtetues individual, nuk rezulton që ai të ketë riparaqitur në atë gjykatë kërkesën e tij fillestare të plotësuar, por ka zgjedhur të kundërshtojë vendimin e saj në Gjykatën Administrative të Apelit, madje duke vënë në lëvizje, për të njëjtin proces gjyqësor, Gjykatën e Lartë, dy herë të tjera Gjykatën Kushtetuese (shih paragrafët 5-9 të vendimit), si dhe GJEDNJ-në. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se sipas nenit 154/a, paragrafi 4, i KPC-së, padia e kthyer për shkak të mospagimit të tarifës së padisë konsiderohet se nuk është paraqitur. Në këto kushte, në rrethanat e mosplotësimit të të metave fillestare të padisë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të provojë interesin e tij të drejtpërdrejtë dhe individual për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.”* (shih paragrafët 13 dhe 14 të vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve).

18. Në lidhje me kërkesën e dytë të paraqitur në Gjykatën e Lartë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 9, datë 19.07.2022, ka vendosur pushimin e gjykimit, mbështetur në pikën 3 të nenit 399/7 të KPC-së, pasi kërkesa për të cilën ajo gjykatë ishte vënë në lëvizje, që lidhej me procesin në gjykatën e apelit, tashmë ishte shqyrtuar dhe gjykuar me vendimin e datës 22.12.2021. Kërkuesi pranon të jetë njoftuar për këtë vendim në datën 03.08.2022.

19. Pas njohjes me këtë vendim, kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës Kushtetuese me kërkesën në shqyrtim, duke ngritur pretendime jo më për kohëzgjatjen tërësore të procesit

gjyqësor të iniciuar prej tij, që ndodhej në pritje të gjykimit të ankimit në gjykatën e apelit, por duke pretenduar se shqyrtimi i kërkesës së dytë në Gjykatën e Lartë është bërë tej afatit 45-ditor të parashikuar nga neni 399/7, pika 2, i KPC-së.

20. Ligji procedural civil ka parashikuar mjetet për t'i garantuar individit mbrojtjen efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm ose edhe për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm (*shih vendimin nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Qëllimi i mjeteve të përcaktuara nga nenet 399/1 e në vijim të KPC-së është parandalimi i kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes dhe shpërblimi i drejtë për shkak të kësaj kohëzgjatjeje. Dispozitat e KPC-së kanë përcaktuar se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), çfarë do të konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7), etj. Sipas nenit 399/3 të KPC-së, shpërblim i drejtë konsiderohet njohja e shkeljes, masat e marra për përshpejtimin e procedurave dhe/ose shpërblimi i dëmit, i përcaktuar në vlerë monetare në nenin 399/10 të këtij Kodi.

21. Këto mjete juridike synojnë të mbrojnë të drejtën e individit për proces të rregullt, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurave të hetimit, të gjykimit të çështjeve (civile, penale ose administrative) dhe të ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë, si dhe shpërblimin e drejtë për këtë shkak. Në këtë kuptim, këto mjete janë instrumente në dispozicion të individit dhe, si të tilla, nuk përbëjnë proces autonom nga ai i gjykimit të themelit të çështjes, i cili të gëzojë, për këtë shkak, edhe mbrojtje autonome të garancive të nenit 42 të Kushtetutës. Nëse do të pranohej e kundërta, atëherë do të humbiste kuptimi i natyrës përfundimtare të gjykimit kushtetues të ankesave individuale. Parë në këtë këndvështrim, ankimi kushtetues synon të mbrojë të drejtën për proces të rregullt pikërisht gjatë procedurave si më sipër, ndërkohë që procedurat e shqyrtimit të kërkesave për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së mund të vlerësohen nga Gjykata vetëm në drejtim të efektivitetit të këtyre mjeteve procedurale. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës me kërkesën në shqyrtim.

22. Në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor në gjykatën administrative të apelit, e cila është vënë në lëvizje për të shqyrtuar ankimin e tij ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, kërkuesi ka marrë përgjigje me vendimin nr. 86, datë 13.07.2022 të Mbledhjes të



Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë, pajisja e tij me një vendim të ri nga Gjykata e Lartë, që nuk ka qenë pjesë e ankimit të mëparshëm kushtetues, edhe pse një fakt i ri, nuk sjell ndonjë ndryshim në lidhje me procesin gjyqësor që ka qenë objekt i vendimit të mëparshëm të kësaj Gjykate.

23. Kolegji vëren, gjithashtu, se kërkuesi i është drejtuar kësaj Gjykate në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur me ankime për të njëjtin proces gjyqësor, duke paraqitur si shkaqe kërkesa të së njëjtës natyrë, që bazoheshin në shumicën e rasteve në vendime jopërfundimtare. Edhe pse me vendime të kolegjeve të kësaj Gjykate i është kërkuar të paraqesë ankim kushtetues kur çështja e tij të jetë përfundimtare ose që të justifikojë interesin për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, duke u konstatuar më pas edhe mungesa e interesit të tij, kërkuesi ka vijuar të paraqesë kërkesa të së njëjtës natyrë dhe për të njëjtat shkaqe, duke shkuar në kufijtë e abuzimit jo vetëm me mjetet ligjore, por edhe me ankimin kushtetues individual.

24. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje të kërkuesit përmbajtjen e nenit 31/c të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit kur Gjykata konstaton se kërkuesi paraqet kërkesë abuzive ose të përsëritur, për të njëjtin shkak dhe objekt, megjithëse ajo është shqyrtuar një herë nga Gjykata, urdhëron gjëmbajtjen e tij dhe në një rast të tillë vendimi përbën titull ekzekutiv. Kjo dispozitë ka për qëllim të shmangë abuzimin me aksesin kushtetues, si dhe shpërdorimin e të drejtave kushtetuese të individëve. Megjithatë, në rastin konkret, në kushtet kur kërkuesi nuk është paralajmëruar më parë me vendim të kolegjeve për mundësinë e gjëmbajtjes së tij për shkak të përsëritjes së kërkesave, çmohet se nuk është e arsyeshme të zbatohet neni 31/c i ligjit nr. 8577/2000.

25. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk përmbush kriteret paraprake, për rrjedhojë nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.